



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA TIRANË
NJËSIA ADMINISTRATIVE PETRELË

Nr. _____ Prot

Petrelë, më __/__/2017

Proçes verbal

Sot, në datë 22.11.2017 u mbajt dëgjese publike në ambjentet e Njesisë Administrative Petrelë me tematike “ **Buxheti për vitin 2018**” për Njësinë Administrative Petrelë, Bashkia Tiranë.

Në këtë takim ishin të pranishëm: Administratori i Njesisë Petrelë **Z. Sokol KUPI**; Drejtori i Drejtorisë së Objekteve në Bashkëpronësi, Koordinimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, **Z. Erind BEJKO**; Drejtor i Drejtorisë Nr. 3 i Shkollave **Z. Fetih Fana**. Të pranishëm të tjerë ishin ndërlidhësit me komunitetin, punonjës të ujësjellësit, punonjës të Njesisë Administrative Petrelë si dhe qytetarë nga kjo njësi.

Programi i këtij takimi:

Z. Sokol Kupi, Administrator i Njesisë Petrelë, pasi i falenderoi të gjithë pjesëmarrësit në mbledhje, përmendi edhe investimet që aktualisht po bëhen dhe janë bërë në këtë njësi:

- Sheshi i Qehasë.
- Restaurimi i Urës së Qehasë.
- Kanalizimin dhe sistemin e ujësjellësit në fshatin Gurrë Madhe.
- Shtrimin e trotuarit të rrugës në fshatin Mullet.

Falenderoj gjithashtu Bashkinë e Tiranës dhe drejtoritë e caktuara për projektet e investuara në ndërtim, rikonstruksionet etj.

Kërkesat për vitin e ardhshëm janë:

- Asfaltimin dhe kanalizimin e rrugës Tagan dhe restaurimin e urës së Zeranikës.
- Ndërtimin e palestrës në shkollën e mesme Ibrahim Hasmema dhe të tualeteve në shkollën 9-vjeçare Petrelë
- Restaurimin e shkollës Mangull dhe Stërmas
- Projekt-pilot për shkarkimin e ujërave të zeza dhe ujin e pijshëm në fshatin Stërmas

Z. Erind BEJKO, Drejtor në Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi, Koordinimi i Njësive Administrative dhe Emergjencat Civile. Pas falenderimeve Z. Bejko përmendi investimet që janë bërë dhe do të bëhen nga Bashkia Tiranë.

Nga Z. Bejko u përmendën këto investime për vitin 2018:

- Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve të Njesisë Administrative Petrelë
- Rikonstrukcion i Urës së Qehasë
- Kanalizime, sisteme vaditëse, ujësjellës etj
- Ndërtimin e një palestere për shkollën e mesme “Ibrahim Hasmema” dhe të tualeteve në shkollën 9-vjeçare Petrelë.
- Ristrukturimin e shkollës Mangull dhe Stërmas.

Diskutime vazhduan në formë bashkëbisedimi midis qytetarëve dhe përfaqësuesve të Bashkisë Tiranë:

Qytetari I

Në fshatin Hekal banorët shprehen se qeveria ka bërë shumë punë por për sa i përket sistemit vaditës fermerët theksojnë se duhen bërë akoma më shumë investime në të.

Qytetari II

Probleme me aksin rrugor Mullet- Fikas- Qeha- Hekal pasi në segmente të ndryshme ka rreshqitje të dheut që përbën një rrezik të madh në kalimin e mjeteve.

Qytetari III

Banorët e fshatit Gurrë e Madhe ankohen për problemin e rrugës dhe mungesës së kanalizimeve.

Qytetari IV

Kërkesa për ngritjen e çerdheve dhe kopshteve në fshatin Shytaj.

Qytetari V

Në fshatin Tagan banorët ankohen për mungesë të kanalizimeve si dhe asfaltimin e rrugës së fshatit.

Mbledhja u mbyll me një falenderim për të gjithë pjesëmarrësit!

Njësia Administrative Petrelë.